



2021

Buxheti

Një vështrim për qytetarët

Ky material mbështetet në Projektligjin për Buxhetin e Vitit 2021 të propozuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në nëntor 2020. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të propozimit të buxhetit 2021.

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pa ndryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar materiale apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi:

Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2021 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën:

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë

e-mail: konsultimepba@financa.gov.al

Paraqitja grafike nga Grid Cartels.

Botimi i këtij dokumenti u mundësua me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore (UN Women) në kuader të projektit rajonal "Financim Transformues për Barazinë Gjinore për një qeverisje gjithpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme në Ballkanin Perëndimor" financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikimin nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e UN Women ose të donatorit të projektit.

Përmbajtja

Mesazh për lexuesin	4
Buxheti i rimëkëmbjes ekonomike	6
Tregues pozitivë makroekonomikë	8
Konsolidimi i shërbimeve publike themelore	10
Bujqësia dhe zhvillimi rural	11
Shendetesia	12
Arsimi	14
Paketa sociale	16
Drejtesia dhe rendi	18
Nxsisim zhvillimin ekonomik dhe mbështesim rajonet	20
Ri-ndërtojmë shqipërinë	21
Nga vinë paratë e buxhetit?	24
Ku shkojnë paratë e buxhetit të shtetit?	25

Mesazh për lexuesin



Zj. Anila Denaj
Ministre e Financave
dhe Ekonomisë

Të nderuar qytetarë, me anë të këtij materiali dëshiroj t'ju prezantoj në mënyrë të thjeshtuar propozimin e buxhetit të shtetit për vitin 2021. Buxheti 2021 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19 përmes skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjes pro-aktive ndaj biznesit, rindërtimit të plotë të banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti si dhe masave parandaluese të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Buxheti 2021 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -6.1 përqind, ekonomia pritet të rrekuperohet

në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

Rritja ekonomike parashikohet **në 5.5 përqind në vitin 2021**

dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 4.9 përqind përgjatë periudhës afatmesme në vijim. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 7.2% e PBB.**

Buxhetin e vitit 2021, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit

Buxheti 2021, i përgjigjshëm ndaj nevojave të burrave dhe grave, synon avancimin e përpjekjeve europiane për barazi gjinore, nëpërmjet planifikimit të fondeve, të cilat adresojnë problematika të pabarazive gjinore në sektorë si: shëndetësia, mbrojtja sociale, arsimi, bujqësia, etj.

ne ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet. Në vijimësi, Projektbuxheti 2021 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2021-2023

do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në procesin e rindërtimit si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ky buxhet vijon të pasqyrojë jo vetëm përpjekjet por edhe

angazhimet konkrete të Qeverisë shqiptare për të adresuar problemet e pabarazive gjinore në të gjithë sektorët. Buxheti i përgjigjshëm gjinor, i integruar në të gjitha fazat e buxhetit publik, vijon të jetë për të pestin vit radhazi një pjesë shumë e rëndësishme e integritit gjinor, jo vetëm në politika, por edhe në buxhetet që i përkthejnë ato në masa konkrete.

Buxheti 2021, i përgjigjshëm ndaj nevojave të burrave dhe grave, synon avancimin e përpjekjeve europiane për barazi gjinore, nëpërmjet planifikimit të fondeve, të cilat adresojnë problematika të pabarazive gjinore në sektorë si: shëndetësia, mbrojtja sociale, arsimi, bujqësia, etj. Politikat sociale mbeten sërish në vëmendjen e qeverisë në këtë buxhet, duke

rritur shkallën e mbulimit me kontributet e pensioneve si dhe me mbështetjen për familjet, burrat dhe gratë, me politikën e **shpërblimit për çdo lindje**. Do të vijojë financimi **i ngritjes së shërbimeve shoqërore** për burrat dhe gratë me aftësi të kufizuar dhe gjithë burrat e gratë, familjet në nevojë, krahas skemave të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Përmirësimi i shërbimeve publike, rritja e aksesit, thjeshtimi i procedurave administrative për sipërmarrjen dhe qytetarët burra e gra, rritja e mirëqenies, ulja e borxhit publik dhe mirëmenaxhimi i financave publike përbëjnë platformën e garantuar nga ky buxhet, mbi të cilën mbështetet aspirata europiane e qytetarëve, burra dhe gra, shqiptarë.



Buxheti i rimëkëmbjes ekonomike

Programimi i të ardhurave për vitin 2021, mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

Ekonomia shqiptare përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli dëme në njerëz dhe në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u

përhap edhe në Shqipëri, masat e ndërmarra ndaj së cilës, impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend. Pas recesionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -6.1 përqind, ekonomia pritet të recuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Programimi i të ardhurave për vitin 2021, mbështet synimet

e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Shtyllat kryesore për përmirësimin e jetesës së burrave dhe grave do të jenë nxitja e punësimit, mbështetja pro-aktive ndaj biznesit, rindërtimi i plotë i banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti si dhe marrja e masave parandaluese të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Prioritetet e buxhetit 2021

Shëndetësia

Shëndetësia do të vijojë të financohet me prioritet, ku një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përballimit të pandemisë **COVID-19**, përfshirë edhe blerjen e vaksinës Anti-Covid 19, si dhe do të ketë një **rritje prej 40% të pagave për mjekët/et, infermierët/et dhe laborantët/ët e sistemit shëndetësor** me një kosto totale vjetore prej **4.5 mld lekë**

Procesi i Rindërtimit

Procesi i Rindërtimit do të financohet me **28 mld lekë** në vitin 2021, ndërkohë, që mbi këtë edhe 1.5 mld lekë parashikohen të vijojnë financimin e bonusit të qerave për familjet e pastreha si pasojë e tërmetit të 26 Nëntorit 2019;

Fermerët

Fermerët, krahas skemës së mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit dhe nga fondet e IPARD si dhe nga fondi i garancisë të bashkëfinancuar me BERZH, do të mund të përfitojnë nga **skema e subvencionimit të naftës**, e cila do t'i kushtojë buxhetit të shtetit për vitin 2021 rreth **1 miliardë lekë**.

Arsimi

Arsimi do të përfitojë një financim në rritje, ku spikat **rritja me 15% e pagës së mësuesve** të sistemit arsimor parauniversitar me një kosto prej 3.5 mld lekë si dhe financimi i prioritetëve të Paktit për Universitetin;

Rritja e pagës

Rritjen e pagës minimale nga 26 mijë në 30 mijë lekë nga e cila do të përfitojnë 330 mijë qytetarë.

Tregues pozitivë makroekonomikë


RRITJA REALE
5,5%
e PBB-së

PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO (PBB)
1682.6
miliardë lekë

INFLACIONI
2,4%
e PBB-së

Perspektiva ekonomike

Rritja ekonomike parashikohet në 5.5 % në vitin 2021 dhe pritet të konvergojë rreth nivelit prej 4 % përgjatë periudhës afatmesme në vijim.




Parashikimi i PBB nominal sipas MFE është 1682,6 miliardë lekë kurse ai i FMN 0,2 miliardë lekë më pak.

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
MFE	1636	1978	1572	1683	1804	1930
FMN	1636	1678	1572	1683	1804	1930
Diferenca MFE-FMN	0,0	0,0	(0.20)	(0.20)	(0.20)	(0.30)

Rritja e punësimit

Norma e papunësisë së burrave dhe grave në Shqipëri parashikohet me ulje në 2021 në nivelin **12.2%** krahasuar me parashikimin e vitit 2020 prej 13.9%.

NORMA E PAPUNËSISË



Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 7.3% e PBB-së**.

Defiçiti buxhetor për vitin 2021 planifikohet të jetë në nivelin 6.5% të PBB dhe borxhi publik do të arrijë vlerën e 66.3% të PBB.

BORXHI PUBLIK



1 KONSOLIDIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE THEMELORE



Rindërtojmë për rimëkëmbje ekonomike dhe mirëqënie për të gjithë burrat dhe gratë në Shqipëri. Buxheti 2021 investon për rritjen ekonomike dhe kthimit në normalitet të vendit.



BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Të ndihmojmë dhe të kujdesemi për fshatin

0.8%
ndaj PBB

- Shtimi i numrit të burrave dhe grave fermere përfituese nga skema e masave mbështetëse në bujqësi nga 2300 përfitues në vitin 2020 në 2400 përfitues në vitin 2021, nga të cilët rreth 15% ose 360 fermerë janë gra fermere.
- 70 mijë fermerë të regjistruar përfitues potencial nga skema e përjashtimit të karburantit për prodhim bujqësor nga akciza, taksa e qarkullimit dhe karbonit.
- Rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet përmirësimit të standardeve dhe garantimit të sigurisë ushqimore, si dhe zhvillimi i zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, duke rritur:
 - ▶ Numrin e burrave dhe grave në bujqësi dhe agropërpunim
- ▶ Sipërfaqet e mbjella me fruta dhe perime.
- ▶ Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim të kryera
- Rritja e % së fermerëve burra dhe gra që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese
- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;

SHËNDETËSIA

Shëndet për të gjithë



3.6%
ndaj PBB

Përtej përballimit me sukses të situatës së shkatuar nga COVID-19, buxheti 2021 synon të mbështesë politikat për mbulimin universal me shërbim cilësor, diagnostikimin dhe parandalimin e hershëm të sëmundjeve dhe shtimin e gamës së medikamenteve të rimbursueshme. Investimet në infrastrukturën shëndetësore për të siguruar aksesin e burrave dhe grave në shërbime themelore ku dhe kur t'u nevojitet janë prioritare:

E gjithë vëmendja për shëndetin e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave

- Shërbimi i kontrollit bazë () falas për 475 mijë pacientë në vit, 50% burra e 50% gra
- Mbi 35% më shumë gra mbi 35 vjeç që përfitojnë nga shërbimet falas të depistimit të kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.9/100 000 në vitin
- 2021 në 2.7/100 000 në vitin 2023.
- Trajtimi me recetë rimbursimi dhe me për mbi 400 mijë pacientë burra dhe gra
- Depistimi i dëgjimit neonatal për 14.000 vajza dhe djem të sapolindur


- Rritja e numrit të pacientëve burra dhe gra të trajtuar:
 - ▶ nga 6.4 milionë në 6.7 milionë vizita në kujdesin parësor
 - ▶ 8400 pacientë burra dhe gra më shumë që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë, 26.000 burra dhe gra të trajtuar me radioterapi,
 - ▶ Nga 215.000 burra dhe gra të trajtuar me dializë
 - ▶ 26 burra dhe gra përfitues të mundshëm të transplantëve renale
 - ▶ Trajtimi i mesatarisht 25 fëmijëve djem dhe vajza në vit me Sindromën Down
 - ▶ Ulja e nivelit aktual prej 15% të pacientëve burra dhe gra të rishtruar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh, nëpërmjet urgjencës;
 - ▶ Reduktimit të kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë




- Infrastruktura shëndetësore më e mirë në çdo skaj të vendit;
- Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e

Urgjencës mjekësore nga 390 mijë thirrje në vitin 2021 në 410 mijë thirrje në vitin 2023, me një kohë reagimi mesatarisht prej 15 minutash.

Objektivat për vitin 2021



Shërbimi i kontrollit bazë falas për 475 mijë pacientë në vit



Trajtimi me recetë rimbursimi për mbi 400 mijë pacientë



Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore

ARSIMI

Çdo vajzë dhe djalë në shkollë



3.8%
ndaj PBB

Buxheti 2021 i jep vëmendje të veçantë kërkesës në rritje për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për djemtë dhe vajzat, zhvillimit të hershëm të tyre; rrit financimet për arsimin parashkollor në dispozicion të bashkive për të mundur e uljen e numrit të vajzave dhe djemve në kopshte e shkolla e në mënyrë të spikatur i kushton vëmendje arsimit universitar, në kuadër të Paktit për Universitetin.

Mbështetje për familjet në nevojë me sigurimin e transportit për më shumë vajza dhe djem, mësues burra dhe gra, programe të veçanta si ai i shkollave komunitare dhe kujdes për vajzat dhe djemtë me nevoja të veçanta nëpërmjet aksesit më të mirë e rritjes së numrit të mësuesve ndihmës. Buxheti investon në shkolla të reja, ngritjen profesionale të mësuesve burra dhe gra, rritjen e cilësisë së teksteve shkollore

dhe sigurimin e teksteve falas për të gjithë vajzat dhe djemtë në arsimin fillor.

Nxënie gjithëpërfshirëse dhe cilësore në arsimin parauniversitar

- Ndërtime të reja, apo rikonstruksione për mbi 180 objekte arsimore, ose rreth 1800-2000 klasa / laboratorë mësimore në

arsimin parauniversitar ku parashikohet të përfitojnë 50,000- 60,000 nxënës dhe 4 500-5 500 mësues dhe edukatorë.

- Transport i 28-30 mijë nxënësve djem dhe vajza që kanë vendbanim mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 10 mijë mësuesve burra dhe gra që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi
- Blerje e teksteve shkollore

për rreth 240 mijë djem dhe vajza të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;

- 1300-1400 nxënës djem dhe vajza të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë me kuotë ushqimore;
- Rritje e numrit të vajzave që regjistrohen në arsimin e mesëm të lartë publik, pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm
- Edukimin nëpërmjet sportit në shkollë, për përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për të rinjtë vajza dhe djem
- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.


Arsimi i mesëm profesional

- Rritja e numrit të të punësuarve vajza dhe djem pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale




- Rritja e numrit të të diplomuarve vajza dhe djem në shkollat e mesme profesionale,
- Rritja e numrit të vajzave dhe djemve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale
- Rritja e numrit të vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuara që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale
- Rritja e numrit të vajzave dhe djemve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale

Objektivat për vitin 2021



Transport i 28-30 mijë nxënësve që jetojnë mbi 2 km larg nga shkolla



Blerje e teksteve shkollore për rreth 240 mijë nxënës



Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit

PAKETA SOCIALE

Mbrojtje sociale për çdo burrë dhe grua në nevojë që askush të mos mbetet pas

1.6%
ndaj PBB

Buxheti 2021 vijon të mbështesë burrat dhe gratë dhe familjet në nevojë nëpërmjet shënjestrimit më të mirë të sistemit të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe veçanërisht fokus në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve shoqërore në mbarë vendin. Krijimi i fondit social synon mbështetjen e njëjësive të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale për burrat dhe gratë e grupeve në nevojë dhe mbështetjen e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike me paketa sociale shëndetësore.

Programet e riintegritimit social do të synojnë mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale.

Mbështetje për punësim dhe shërbime sociale

- Skema e re e vlerësimit dhe programet e ri-integritimit social mbështesin rreth 3000

familje dhe burra e gra në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, nga ku mbi 12% të përfituesve janë gra kryefamiljare

- Numri i burrave dhe grave me aftësi të kufizuar si

dhe kujdestarëve të tyre do të rritet nga 163 mijë në 171 mijë, 39% e të cilëve janë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara


- Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve burra e gra të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- Shtimin e numrit të burrave dhe grave dhe familjeve rome e egjyptiane që përfitojnë nga skema, nga 2640 në 2800
- Rritja mbi 60% e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të reinteguara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social
- Aplikimi i Fondit Social në të paktën 20 bashki




Mbështesim familjet e reja dhe burrat e gratë në nevojë:

- Shpërblimi në lindje: 2.2 miliardë lekë për shpërblimin për çdo lindje,
- Pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: 21 miliardë lekë në vit
- Pagesat e papunësisë dhe mbështetje për punësim: mbi 1 miliard lekë në vit
- 1 miliard lekë për ish-të përndjekurit burra dhe gra;

Objektivat për vitin 2021



Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.



2.2 miliardë lekë për shpërblimin për çdo lindje, për të mbështetur rreth 30 mijë familje



Pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar: 21 miliardë lekë në vit

DREJTESIA DHE RENDI

Siguri dhe drejtësi për burrat dhe gratë



2%
ndaj PBB

Buxheti për vitin 2021 vijon të prioritarizojë vazhdimin e Reformës në Drejtësi; jetësimin e reformës në Drejtësi për të miturit; forcimin e Luftës kundër Korrupsionit në Administratë; garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të burrave dhe grave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe sigurimin e ri-integrimit të tyre në shoqëri edhe nëpërmjet rritjes së performancës në shërbimin e provës.

Garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, janë prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, duke përmirësuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet, parandalimin dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore, në funksion të një kontrolli më efektiv dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Drejtësi për ish-pronarët burra dhe gra dhe zgjidhje e problemeve sociale

- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 1000 që është aktualisht në 1,600 në 2023; Ndarja e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e

kompensimit duke bërë që të rritet numri subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

Përmirësimi i Sistemit të Burgjeve

- Norma e recidivitit (burra) të ketë një trend konstant 18% ndër vite;
- Norma e recidivitit (gra) të ketë një trend rënës nga

- 1% që është aktualisht;
- Të dënuar që punësohen pasi fitojnë lirinë të rritet nga 10% e totalit që është aktualisht.

Vëmendje për gratë dhe familjet

- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje nga 18 min në 2019 në 14 minuta në 2021
- Rritja e numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për gratë dhe vajzat e dhunuara në masën 10%

Siguri në rrugë dhe shërbim policor miqësor

- Përmirësimi i sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të burrave e grave, sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit, nga 1936 raste që parashikohen në vitin 2020;




- Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit
- Reduktimi i kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 20 minuta në

vitin 2020 në 13 minuta në vitin 2021).

- Shtimin e numrit të grave dhe vajzave të diplomuara në Akademinë e Policisë deri në 41% ndaj totalit në vitin 2022, me qëllim realizimin e barazisë gjinore edhe në forcat e Policisë


Objektivat për vitin 2021



Rritja e numrit të masave të menjëhershme mbrojtëse për gratë dhe vajzat e dhunuara në masën 10%



Reduktimi i kohës së reagimit të shërbimeve policore



Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet

2 NXISIM ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE MBËSHTESIM RAJONET



- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve "Made in Albania";
- Rritja e përpjekjeve për të reduktuar informalitetin e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si pengesë kyçe në aksesin e financimeve të SME-ve, nëpërmjet:
 - ▶ Rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga Fondi i Konkurrueshmërisë
 - ▶ Avancimit të mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit
 - ▶ Nxitjes së krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up
 - ▶ Mbështetjes së sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarëve nëpërmjet "Fondit në mbështetje të biznesit kreativ", ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë
 - ▶ Sigurimi i implementimit efektiv të masave të "gjelbëra" të planifikuara për SME-të nëpërmjet ridizenjimit të skemave mbështetëse.
- ▶ Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bizneseve, përmes aksesit të lehtë të informacionit
- ▶ Zhvillimi i një qasje holistike në mbështetje të SME-ve në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesmarrjes së Shqipërisë në rrjetin e Enterprise Europe Network, Shtylla e Programit COSME.
- ▶ Mbështetja e rreth 400 bizneseve të vogla e të mesme për rimbëkëmbjen ekonomike. Kjo politikë do të mbështetet me fonde buxhetore prej 250 milionë lekësh në total për vitin 2021.

INFRASTRUKTURA DHE PRODUKTIVITETI

Ri-Ndërtojmë Shqipërinë

1.6%
ndaj PBB

Në **26 Nëntor 2019, Shqipëria u godit nga një tërmet i fuqishëm** me magnitudë 6.3 i shkallës Rihter, më i madhi i regjistruar në vend në 30 vitet e fundit. Si pasojë e fatkeqësisë, mbi 202 mijë burra dhe gra u afektuan në mënyrë direkte dhe indirekte. Tërmeti shkaktoi 51 viktima dhe 913 të plagosur. Për më tepër, më shumë se 17 mijë burra dhe gra u zhvendosën nga vendbanimet ekzistuese për t'u strehuar në struktura të përkohshme, e më pas në banesa me qira të garantuara nga qeveria shqiptare. Dëmi ekonomik nga tërmeti sipas raportit të detajuar të vlerësimit, të hartuar nga Banka Botërore, Komisioni Europian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara, rezultoi në vlerën mbi 1.1 miliardë lekë.

Ekonomia shqiptare humbi gati 7% të prodhimit të Brendshëm Bruto, në pak sekonda. Procesi i Rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga pesë programe, në funksion të rindërtimit pas tërmetit, përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore:

- ▶ Programi i zhvillimit të objekteve të reja
- ▶ Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike
- ▶ Programi i krijimit të fondit të banesave
- ▶ Programi i granteve të rindërtimit
- ▶ Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike

Në vitin 2020, Programi i Rindërtimit u financua me një buxhet në vlerën 34 miliardë lekë, nga të cilat:

- ▶ 31 miliardë lekë buxheti i shtetit
- ▶ 3 miliardë lekë grante të planifikuara

Ndërtojmë akse jetike për burrat dhe gratë dhe biznesin, sigurojmë infrastrukturë ujore për burrat dhe gratë dhe turizmin:

Buxheti 2021 investon në infrastrukturën e nevojshme për të rritur zhvillimin ekonomik. Ky buxhet garanton investime për projekte të rëndësishme të transportit rrugor në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve në të gjithë vendin: 2.9% ndaj PBB



Transporti dhe aksesimi

- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.

- 3483 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2022 në të gjithë territorin;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë burrash dhe grash, djem dhe vajzash dhe numri i pikave të zeza

- me 23%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.
- **Mirëmbajtja e rrjetit kombëtar të rrugëve** me 3.4 miliardë lekë nga buxheti dhe Banka Botërore për rritjen e cilësisë dhe sigurisë në lëvizje
- 1,2 miliardë lekë për hekurudhën Tiranë-Durrës dhe Tiranë – Rinas

3483 km

rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2022 në të gjithë territorin;

1,2 MILIARDË

lekë për hekurudhën Tiranë-Durrës dhe Tiranë – Rinas

3,4 MILIARDË

lekë për mirëmbajtja e rrjetit kombëtar të rrugëve nga buxheti dhe Banka Botërore



Ujë për burrat dhe gratë

Reforma në sektorin e ujit vijon të jetë një nga prioritetet e Qeverisë. Ajo mbështetet në reformimin e mirëqeverisjes dhe orientimin e investimeve drejt performancës, si dhe drejt sigurimit të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, duke sjellë kështu një përmirësim të ndjeshëm dhe të shumëpritur

të jetesës së burra dhe grave, djemve dhe vajzave, sidomos në zonat rurale:

- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar nga 12.1 orë në vitin 2013 në 20.5 orë në vitin 2023. (për vitin 2021 18.1 orë)
- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në zonat Urbane nga 11 orë në vitin 2013 në

23.1 orë në vitin 2023. (për vitin 2021 21.5 orë)

- % e mbulimit të popullatës me ujëmatësa duke shmangur kësisoj faturimin aforfe nga 59.18% në vitin 2013 në 94% në vitin 2023.

Zhvillim për industrinë dhe shfrytëzimi i denjë i burimeve natyrore:

- Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit minerar dhe rritja e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore;
- Nxitja e interesit të biznesit vendas dhe të huaj për mundësi zhvillimi veprimtarish industrial
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e Lëkurë-Këpucës, industrisë së bakrit, nikel-silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QGTK dhe hartimi i raporteve mjedisore si dhe zhvillimi i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

18.1 ORË

Furnizim me ujë të pijshëm në rang kombëtar për vitin 2021

21.5 ORË

Furnizim me ujë të pijshëm në zonat Urbane për vitin 2021

94%

e mbulimit të popullatës me ujëmatësa në vitin 2023

Nga vijnë paratë e buxhetit të shtetit?

Në vitin 2021, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 479 miliard lekë, nga këto, të ardhurat tatimore 437 miliard lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat 311 miliard lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 99,7 miliard lekë.

Të ardhurat e përgjithshme

479
miliardë lekë

Të ardhurat tatimore

437
miliardë lekë


Të ardhurat nga tatimet
dhe doganat

311
miliardë lekë

Të ardhurat nga
kontributet

99,7
miliardë lekë

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE




Ku shkojnë paratë e buxhetit të shtetit?


Shpenzimet kryesore

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2021 është planifikuar **587.6 miliardë lekë** ose **34.9% e PBB**.

SHPENZIMET BUXHETORE SIPAS FUNKSIONEVE TË QEVERISË (NË MILION LEKË)



SHPENZIMET BUXHETORE SIPAS FUNKSIONEVE TË QEVERISË (NË % ndaj totalit)



Pavarësisht nivelit relativisht të lartë që vjen si pasojë e efekteve negative të tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, deficiti buxhetor vijon të mbështesë ekskluzivisht financimin e investimeve publike. **Në fund të vitit 2023, niveli i deficitit buxhetor parashikohet të ulet në 2.3% të PBB dhe balanca primare të kthehet në nivele pozitive, duke përmbushur objektivin madhor të Qeverisë për uljen graduale të stokut të borxhit publik.**

